

Qebir Avziu, PhD¹
Afrim Osmani, PhD²
Nazmije Shaqiri, MA³

UDK:
343.9.02:341.24

FENOMENOLOGJIA E KRIMIT TË ORGANIZUAR

ФЕНОМЕНОЛОГИЈА НА ОРГАНИЗИРАН КРИМИНАЛ

PHENOMENOLOGY OF ORGANIZED CRIME

Abstract

Today the most interesting theme after terrorism and global warm, in all around the world is organized crime. This is because this type of crime, strikes at the very foundations of modern society and represents a serious obstacle to the economic development of ich country. Recently anyone has heard about organized crime, but only a few people know what organized Crime is really. In this paper the main purpose will be to explain the basic features of organized crime and the phenomenology of organized crime in our society. We have created impression about organized crime, by looking at the Hollywood films, there we see how they functions and we see the people who live in a dream luxury, with a beautiful home. They are always dressed in suit, with clean shoes, but also, at the same time we can see that insaide organization have a very strict discipline, where orders are respected by each member of organizations. In this paper, we will also focus and disscuss about Palermo Convention against transnacional crime and Characteristics that provides in this conventions.

Key Words: organized, crime, phenomenology, Palermo conventions etc.

¹ Faculty of law - University of Tetova

² Faculty of law - University of Tetova

³ PhD candidate, Faculty of law - University of Tetova

FENOMENOLOGJIA E KRIMIT TË ORGANIZUAR

Me siguri se sot temë më interesante të cilës i kushtohet kujdes i veçantë, pas Terrorizmit dhe ngrohjes globale, është krimi organizuar. Kjo është kështu, pasi ky lloj i krimit godet rëndë themelet e shoqërisë moderne dhe paraqet pengesë serioze në zhvillimin ekonomik të një vendi. Sot thuajse nuk ka kush që nuk ka dëgjuar për krimin e organizuar, por shumë kush nuk e di se çka vërtet paraqet ky fenomen apo nuk mund të bëjë dallim me krimet tjera në përgjithësi. Prandaj në vijim, shkurtimisht me disa fjalë, do të mundohemi të paraqesim tiparet themelore të krimit të organizuar dhe format e paraqitjes së tij në shoqërinë tonë. Kur bisedojmë për krimin e organizuar, atëherë sikur para syve tanë menjëherë na paraqitet portreti i njeriut i cili gjithmonë është i veshur me një kostum të bukur, me kravatë, persona që jetojnë në shtëpi shumë luksoze, me vetura të shtrenjta dhe gjithmonë të shoqëruar nga vajzat më të bukura, e që vazhdimisht në buzë mbajnë duhanin. Së paku kështu kemi krijuar bindjet nga filmat Holivudian që kemi parë me aktorët e famshëm, si Al Paçino, Marlon Brando etj, për të cilët askush nga ne nuk mund të mohojmë se kemi krijuar edhe simpati.

1. Hyrje

Kur bisedojmë për krimin e organizuar, atëherë sikur para syve tanë menjëherë na paraqitet portreti i një njeriut i cili gjithmonë është i veshur me një kostum të bukur, me kravatë, persona që jetojnë në shtëpi shumë luksoze, me vetura të shtrenjta dhe gjithmonë të shoqëruar nga vajzat më të bukura, e që vazhdimisht në buzë mbajnë qibukun. Së paku kështu kemi krijuar bindjen nga filmat e Holivudit që kemi parë me aktorët e famshëm, si Al Paçino, Marlon Brando etj, për të cilët askush nga ne nuk mund të mohojmë se kemi krijuar edhe simpati. Kjo është kështu sepse ata vërtet tregohen me pamjen e një personi serioz, një zotëriu të vërtetë, që nga ana tjetër të le të kuptosh se, anëtarët e organizatave kriminale, jetonin në një luks të paimagjinuar, me një stil të lartë të jetës, që kërkon shpenzime të mëdhaja. Nuk duhet harruar edhe se të qenurit anëtar i organizatës kriminale nënkupton edhe fuqi dhe pushtet. E gjithë kjo padyshim është shumë joshëse për shumë njerëz dhe shumë persona ëndërrojnë të krijojnë një organizatë të tillë ose të jenë pjesë e saj. Por, kuptohet se vetëm përshkrimi i pamjes së jashtme nuk është i mjaftueshëm që ne të mund identifikojmë se këta ose ata janë anëtarë

të krimit të organizuar, sepse thelbi i organizatave kriminale bazohet në kritere tjera, e jo mbi kostumet e tyre.

Quhet **krim i organizuar**, ngase delikuentet profesionistë, gjatë ndërmarrjes së aktiviteteve dhe veprimeve kriminale, i planifikojnë dhe koordinojnë ato në mënyrë të veçantë, për këto qëllime ata inkorporojnë dhe shfrytëzojnë grupe, shoqata dhe organizata të themeluara më parë ose shoqatat e reja të cilat si veprimtari të tyre oficiale e kanë marrjen me transaksione të ndryshme, të cilat nuk janë të ndaluara në pikëpamje formale ku këto grupe, shoqata dhe organizata janë të paraqitura dhe të regjistruara në mënyrë legale, duke lajmëruar një veprimtari e cila gjoja ushtrohet, por në esencë, veprimtaria e tyre është marrja me aktivitete kriminale. Termi “**krim i organizuar**” është përdorur për herë të parë në vitin 1896, në raportin vjetor të shoqatës për parandalimin e krimit, në New York, ku ky term përdorej për veprimtaritë e prostitucionit dhe bixhozit, që në atë kohë kishin filluar të ushtroheshin nga organizata që vepronin në formë të planifikuar. Çdo organizatë kriminale ka karakteristikat e veta, ku është e pranishme lidhshmëria e më shumë personave gjatë kryerjes së veprimeve kriminele, çdo organizatë ka strukturën e saj varësisht nga forma e organizimit, në të ekziston një disiplinë e posaçme ku në mospërfilljen e urdhrave varësisht nga hierarkia pason ndëshkimi, në të shumtën e rasteve likuidimi i personit. Organizatat kriminale veprojnë në bazë të planit me grupin e tyre kriminel, ku veprimet e tyre i realizojnë përmes shantazheve, kërcënimeve, mitos, e në disa raste edhe përmes lidhjeve me strukturat e larta shtetërore. Mirëpo jo të gjitha organizatat kriminele veprojnë në mënyrë të njëjtë, veprimi i tyre dallon nga vendi apo organizimi, por të gjitha kanë një parim të përbashkët, fshehtësinë e plotë dhe respektimin e urdhrave të ardhura nga më lartë. Format më të shpeshta të krimit të organizuar janë: kontrabanda me narkotikë, larja e parave, falsifikimi i parave, prostitucioni, trafikimi me njerëz etj.

Një fakt i cili na preokupon dita ditës, është se gati në të gjithë vendet e botës është i pranishëm krimi i organizuar, i cili në mënyrë direkte apo indirekte është i prekur nga ana e pushtetit dhe politikës, prandaj luftimi dhe parandalimi i këtij fenomeni gjithnjë bëhet shumë i vështirë. Nëse analizohet mirë termi krim i organizuar, do të shohim se përmban dy nocione: **krim**, që nënkupton veprime të ndaluara me ligj dhe të definuara si vepra penale dhe **organizim**, që nënkupton se personat që kryejnë këto vepra penale veprojnë në mënyrë të organizuar. Me

siguri se në definimin e krimit të organizuar nuk paraqet vështirësi nocioi krim, sepse në mes shkencëtarëve ekziston pajtueshmëri lidhur me këtë term, por kur është fjala për termin organizim, atëherë sikur paraqiten ngatërresa dhe mjegullohet kuptimi dhe definimi se çka në realitet paraqet krimi i organizuar. Në fakt, shumë kush nuk mund të bëjë dallimin në mes krimit të organizuar dhe krimit të paorganizuar, sikur nuk e kemi të qartë se ku qëndron kufiri në mes këtyre dy llojeve të krimeve. Kjo do të thotë se kompleksiteti i çështjes nuk qëndron tek termi krim, por tek termi organizim.

Nocioni organizim ka më shumë kuptime, por në përgjithësi nënkupton mënyrën sistematike dhe të planifikuar të veprimit, në të cilën janë të angazhuar më shumë persona. Këtu fjala është për persona që janë bashkuar qëllimisht për të kryer vepra penale dhe se çdo njëri është i vetëdijshëm për rolin dhe funksionin që ka në organizatë. Organizata kriminale funksionon në mënyrë sistematike, sipas një plani të detajuar, ku secili në mënyrë të hollësishme ka të përcaktuar rolin e tij. Organizata kriminale funksionon sipas parimit të hierarkisë, ku urdhërat jepen nga nivelet më të larta, deri tek nivelet më të ulta. Secila nga këto ka funksionet dhe detyrat e caktuara. Brenda organizatës ekzistojnë rregulla dhe disiplinë shumë strikte, mosrespektimi i të cilave pason me sanksione të ashpra.

Sot në të gjitha vendet e botës nuk ekziston një definim gjithëpërfshirës, por kryesisht në mes kriminalistëve dhe kriminologëve ekziston një konsensus lidhur me termin që duhet të përfshijë kriminaliteti i organizuar. Pastaj, nga shumica e vendeve të botës është i pranuar definimi i krimit të organizuar sipas asaj që jep Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit transnacional (2001), e njohur si Konventa e Palermos. Sipas kësaj konvente, që të bëhet fjalë për krimin e organizuar, domosdo duhet të plotësohen në mënyrë kumulative disa kriteret. Por, shkenca, përveç këtyre, ka ngritur edhe disa kriteret tjera plotësuese, që po ashtu janë të rëndësishme në definimin e krimit të organizuar. Sipas konventës së Palermos, me termin organizatë kriminale do të nënkuptohet grupi i organizuar nga tre apo më shumë persona, që veprojnë një periudhë të caktuar me tendencë të kryerjes së një apo më shumë veprave penale serioze, me qëllim të fitimit financiar - profitit. Nga definicioni i lartpërmendur, shihet se fjala është për këto kriteret:

- Grup të organizuar prej tre (3) apo më shumë personave;
- Veprojnë brenda një periudhe të caktuar, duke kryer një apo më shumë vepra penale serioze;

- Qëllimi apo motivi i organizatës është profiti.

Nga **kriteri i parë** shihet se fjala është për numrin e personave që janë të kyçur në organizatë. Sipas kësaj, numri i personave të kyçur në organizatë kriminale nuk mund të jetë më pak se tre, kurse nuk përcaktohet numri më i madh i anëtarëve të organizatës kriminale. Kjo as që është e mundur, sepse ky numër te disa organizata kriminale (Triada, Yakuza etj.) kalon edhe disa mijëra anëtarë. Prandaj e rëndësishme është që të argumentohet pjesëmarrja e të paktën tre personave në aktivitete kriminale.

Kriteri dytë ndërlidhet për periudhën kohore dhe veprat penale serioze. Çdo organizatë kriminale krijohet me tendencë që të veprojë një periudhë sa më të gjatë kohore. Organizata kriminale nuk krijohet që të kryejë vetëm një vepër penale dhe pastaj të shuhet, por qëllimi është funksionimi në një distancë të gjatë kohore. Sa i përket veprave penale, atëherë, që të plotësohet kriteri i dytë, fjala duhet të jetë për vepra penale që janë serioze. Sipas kësaj konvente, me vepra penale serioze do të nënkuptohen veprat penale për të cilat ligji parasheh dënim, jo më pak se katër vjet burg. Pra, nëse eventualisht bashkohen tre apo më shumë persona dhe kryejnë një apo më shumë vepra penale, për të cilat ligji parasheh më pak se 4 vjet burg, atëherë fjala nuk është për krimin e organizuar, por për një grup personash që kanë kryer vepër penale dhe do të ndiqen për këtë vepër penale, psh: vjedhje.

Kriteri tretë ndërlidhet me motivin apo shkakun që ka nxitë këta persona të ngrisin dhe të bashkohen në organizatën kriminale. Qëllimi i organizatës kriminale dhe i të gjithë anëtarëve të saj është profiti. Pra, anëtarët e organizatës kriminale kryejnë vepra penale (serioze), me qëllim të përfitimit të mirave ekonomike. Organizata kriminale nuk dëshiron që të ndryshojë sistemin kushtetues të shtetit apo të ndryshojë rregullimin e saj politik, por thjesht është e interesuar vetëm për profitin. Përveç këtyre kriterëve primare që janë të domosdoshme, kërkohet që të plotësohen edhe disa kritere tjera sekundare apo plotësuese, që po ashtu janë tepër të rëndësishme. Prandaj në vazhdim do të përmendim këto kritere.

- **Organizata kriminale** vepron në mënyrë të planifikuar. Që të realizojë këtë qëllim, anëtarët

e organizatës janë të interesuar që të kenë raporte të mira me pushtetmbajtësit dhe kështu të dobësohen mekanizmat për luftimin e tyre. Që të arrijnë këtë qëllim, ata janë të gatshëm që deri tek strukturat e larta të shtetit të arrijnë nëpërmjet korrupsionit, por edhe mjeteve të

dhunshme. Këtu fjala është për persona që janë bashkuar qëllimisht dhe se çdo njëri është i vetëdijshëm për rolin dhe funksionin që ka në organizatë. Organizata kriminale funksionon në mënyrë sistematike, sipas një plani të detajuar, sipas hierarkisë së caktuar. Brenda organizatës vërehen nivelet e funksionimit, duke filluar nga shtresat më të larta, të mesmet dhe deri tek ato më të ultat. Secila nga këto ka funksione dhe detyra të caktuara. Organizata kriminale funksionon mbi rregulla shumë strikte dhe sanksione të ashpra. Përveç kësaj, një definicion të shkëlqyer ka dhënë edhe autori amerikan, Hauard Abadinski (Hoëard Abadinsky), sipas të cilit “krimi organizuar paraqet shoqatë joideologjike të disa individëve, në mes të cilëve ekziston një lidhje e fuqishme interaktive dhe me një hierarki të ndarë në tre nivele. Organizata ka për qëllim profitin, të cilin e siguron me veprimtari të paligjshme dhe të ligjshme dhe ka tendencë të ekzistencës së përhershme”.

Nëse analizojmë definicionin e sipërpërmendur, atëherë mund të veçojmë se karakteristikat themelore të krimit të organizuar janë:

- 1- Organizatë kriminale
- 2- joideologjike
- 3- hierarkia
- 4- kufizimi anëtarësisë
- 5- ekzistenca e përhershme

1) **Organizat kriminale.** Kur themi organizatë kriminale, atëherë me siguri e kemi parasysh se këtu nuk është fjala për shoqatë humanitare, por organizatë e cila me vetëdije është e formuar enkas për të siguruar profit në mënyrë të kundërligjshme apo nëpërmjet kryerjes së veprave penale. Pra, në këtë shoqatë janë bashkuar personat të cilët janë të vetëdijshëm se veprimtaria e tyre është në kundërshtim me dispozitat ligjore. Filozofia e krijimit të organizatës është shumë e thjeshtë dhe lehtësisht kuptohet se ata kanë vetëm një qëllim, realizimin e profitit. Kurse metodat se si e arrijnë këtë qëllim janë joligjore dhe shpeshherë edhe jonjerëzore. Pra, mund të thuhet se organizatat kriminale formohen për shkak të etjes së madhe për të fituar pasuri në mënyrë të kundërligjshme, prandaj mund të themi se veprimtaria e tyre nuk është e mbështetur mbi motive politike. Mirëpo, kjo s’do të thotë se në raste të caktuara, organizata nuk do të veprojë edhe mbi shkaqe politike; këto janë sidomos rastet kur subjektet politike kanë nevojë për ndihmën e tyre. Kështu, jo rrallë herë punët e pista që shkojnë në llogari të subjektit politik, i pastron organizata, përfshirë këtu vrasje, rrëmbime, kidnapime

(marrje peng) dhe krime tjera shumë të rënda, të cilët vërtet trondisin shoqërinë. Praktika ka treguar se kjo ndihmë më së shumti vjen gjatë fushatave zgjedhore, kur është e nevojshme grumbullimi i votave duke mbjellë trishtim dhe panik tek popullata. Por nuk duhet harruar se organizata punët e fëlliqura në llogari të subjektit politik nuk i ushtron pa ndonjë interes të caktuar, sepse ajo më vonë me këmbëngulësi do të kërkojë që anëtarët e saj të mos ndiqen penalisht dhe të mos pengohet në veprimtarinë kriminale. Sigurimi i imunitetit dhe proteksioneve të nevojshme nga ndjekja penale, janë kushti themelor për mbijetesën e organizatës. Është e qartë se organizata nuk do të arrijë të mbijetojë, nëse nuk arrin të korruptojë një rrjet të gjërë të zyrtarëve të shtetit (gjykatës dhe policë), të cilët në çdo moment do të keqpërdornin pozitën e tyre dhe do të viheshin në mbrojtje të organizatës. Shumica e kriminologëve janë të mendimit se kjo është karakteristika themelore që krimin e organizuar e dallon nga krimet tjera. Pra, nuk mund të bëhet fjalë për krim të organizuar në qoftë se struktura të larta të shtetit nuk janë të lidhura me organizatat kriminale.

2) **Karakteri joideologjik.** Karakteri i funksionimit të organizatës është shumë i rëndësishëm, sepse motivet pse është krijuar dhe çka dëshiron të arrijë organizata, janë thelbësore në vënien e kufirit në mes **organizatave kriminale** dhe **organizatave terroriste**. Kështu, organizata kriminale, siç përmendëm, është formuar enkas për fitimin e pasurisë dhe në arritjen e këtyre objektivave ajo gjithmonë është e përgatitur për përdorimin e mjeteve të dhunshme dhe korrupsionit. Për dallim nga këto, motivet e organizatave terroriste nuk mbështeten mbi profitin, por mbi idetë filozofike dhe mbi shkaqet politike. Ngjashmëria ekziston vetëm për sa i përket dhunës. Kështu, të dyja organizatat përdorin dhunën, me dallim të asaj se terrorizmi është shumë më i përgjakshëm në arritjen e objektivave të tij. Pra, në bazë të motivit se çka dëshiron të realizojë organizata, bëhet distinkcion i qartë në mes krimit të organizuar dhe organizatave terroriste.

3) **Hierarkia.** Kuptohet se organizata funksionon mbi parime shumë strikte, të cilat mund të jenë të shkruara apo verbale. Por, si do që të jenë, respektimi i tyre është i padiskutueshëm. Mund të thuhet se një ndër shkaqet e rëndësishme në suksesin e organizatës, është respektimi i rregullave të organizatës. Kështu, çdo anëtar mbrenda organizatës i ka të qarta rregullat e organizatës, sidomos obligimin e heshtjes për të gjitha punët e organizatës, kështu që roli dhe puna e secilit janë të definuara paraprakisht. Kështu, organizata, për dallim nga shoqatat

tjera kriminale, ka një strukturë të ndarë së paku në tre nivele. Në krye të organizatës qëndrojnë udhëheqësit apo ideatorët e organizatës. Në nivelin e dytë qëndrojnë menaxherët, të cilët njëherit janë edhe ekspertë të fushave të ndryshme dhe në nivelin e tretë janë ushtarët që realizojnë dhunshëm planet e organizatës. Nga të tre shtresat, në praktikë më i njohur është niveli i tretë, sepse veprimet e tyre janë të dukshme dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë manifestohen në botën e jashtme. Prandaj, në luftën kundër krimit të organizuar mund të identifikohen dhe të burgosen vetëm ushtarët, kurse anëtarët e nivelit të dytë, e posaçërisht të parit, mbesin nën hije.

4) Kufizimi i anëtarësisë. Shpeshherë në të kaluarën është menduar se krimi organizuar identifikohet me atë që anëtarët e tij patjetër duhet t'i takojnë një etniteti apo një race të caktuar, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet lojaliteti saj. Kështu, në SHBA gjatë kohë është menduar se krimi organizuar është karakteristikë vetëm për nacionalitetin italian dhe se krimi organizuar nuk duhet kërkuar jashtë këtij etniteti. Mirëpo, sot mbijetesa e organizatave kriminale, në kuptimin e vërtetë të fjalës, ndërlidhet me krimin transnacional, veprimet e kryerjes manifestohen në territoret e më tepër shteteve, ku anëtarët dallojnë si nga etniteti, ashtu edhe për nga raca apo religjioni. Kështu sot anëtarët e krimit të organizuar zgjidhen në bazë të karrierës kriminale të personit. Prandaj numri i tyre sot është i ndryshëm dhe nuk kufizohet mbi nacionalitetin e personit, por mbi besueshmërinë dhe lojalitetin e tij ndaj organizatës

5) Tendencë që të ekzistojë përgjithmonë. Organizata formohet me qëllim të ekzistencës në një periudhë kohore të gjatë. Kuptohet se shoqata është e përgatitur të përdorë metodat e dhunshme dhe korrupsionin, varësisht nga nevoja. Vetë anëtarët e organizatës janë të interesuar që organizata të ketë jetë të gjatë, sepse brenda saj mundësohet jeta luksoze, e cila jashtë saj nuk mund të arrihet. Dihet se secili anëtar i organizatës ka fitimin e caktuar dhe privilegje të tjera, të cilat nuk janë të vogla. Organizata ka tendencë të futet në bizneset në fushën e bixhozit, prostitucionit, pornografisë, piraterisë, tregtisë me substanca narkotike dhe biznese tjera të paligjshme të cilat sjellin profite të mëdha.

Të gjitha këto që i thamë deri më tani, përbëjnë shkurtimisht tiparet dhe paraqesin fenomenologjinë e krimit të organizuar. Por, që të paraqitet dhe të ekzistojë (mbijetojë) krimi organizuar, paraprakisht duhen të plotësohen në mënyrë kumulative edhe tre kritere tjera: Mosfunksionimi i shtetit ligjor, korrupsioni dhe sistemi demokratik.

- **Mosfiksionimi i shtetit ligjor.** Kuptohet se krimi organizuar nuk do të mund të zhvillohej në një vend ku sundon shteti i së drejtës. Që të krijohen organizatat e kundërligjshme, në rend të parë është e nevojshme që shteti të jetë i dobët dhe jofunksional. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se shteti dhe institucionet e tij nuk janë në gjendje të ushtrojnë pushtetin apo funksionin themelor të tyre, që të mbrojnë qytetarët dhe kapitalin e tyre nga veprimet e kundërligjshme. Mungesa e kapacitetit ligjor të shtetit që të ushtrojë pushtetin, sjell në skenë paraqitjen e grupeve që do të luajnë rolin e shtetit dhe do të ofrojnë “mbrojtje dhe siguri”. Në këto kushte, qytetarët detyrimisht duhet të drejtohet tek “ata” që t’i mbrojnë nga po “ata”, duke dhënë shuma të konsiderueshme të parave. Në këto situata, kur shteti nuk garanton siguri, mbrojtja e personave kthehet në profesionin më të paguar në shoqëri. Këto janë periudhat kur organizata së pari shkakton kriminalitetin dhe situata konfliktuale, që pastaj të ofrojë mbrojtje nga krimi.

- **Korrupsioni.** Që të paraqitet krimi organizuar, nuk është e mjaftueshme vetëm që shteti të jetë i dobët, por edhe i korruptuar, edhe atë në përmasa endemike. Kuptohet se korrupsioni është ajo që shtyt rrotat e shoqërisë të rrotullohen mbrapsht dhe bën që askush të mos ketë besim tek shteti. Korrupsioni është mjet që detyron zyrtarët e shtetit të mos veprojnë në situata të caktuara, duke i dhënë hapësirë krimin të organizuar, ose të veprojnë në interes të organizatës që të sigurojë imunitetin e nevojshëm. Por imuniteti nuk mund të jetë plotësisht, sepse gjithmonë janë gjetur persona të ndershëm që kanë luftuar dukuritë negative në shoqëri dhe që kurrë nuk janë korruptuar.

- **Shteti demokratik.** Vetëm në një shtet demokratik mund të zhvillohen organizatat kriminale. Kjo është kështu, pasi vetëm nëpër këto sisteme qytetarëve u jepet hapësirë e gjërë të veprojnë dhe të krijojnë organizata të ndryshme. Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut vërtet në një masë të gjërë ka kufizuar shtetet demokratike të veprojnë kundër këtyre organizatave apo duhet një punë e gjatë dhe shumë e lodhshme të luftohet një organizatë e këtillë. Kurse në vendet jo demokratike, ku shteti kontrollon çdo gjë, krijimi i këtyre organizatave nuk mund të bëhet pa lejen e shtetit. Ndonëse sot edhe Kina ka një sistem socialist, ku Triada është një ndër organizatat më të mëdha botërore, por megjithatë Kina ka tregun e lirë dhe lejon pasurimin e qytetarëve dhe funksionimin e organizatave të ndryshme.

Në vendin tonë, krimi i organizuar është një fenomen relativisht i ri, andaj mund të thuhet se zanafilla e tij lidhet me ndryshimet e

sistemeve politiko-shoqërore, sidomos me ndryshimin e garniturave të vjetra të qeverisjes dhe ardhjen në pushtet të personave të rinj, të cilëve në rend të parë u ka munguar përvoja me udhëheqjen e shtetit. Përveç kapacitetit të dobët juridik, krimi i organizuar në vendet e Ballkanit u paraqit edhe si rezultat i konflikteve të njëpasnjëshme që ndërlidhen me sigurin e vendit, luftërat e ashpra, sanksionet ndërkomëtare (embargot), të cilat detyrimisht do të sjellnin në paraqitjen e krimit transnacional, që do të reflektohej me humbje kolosale në ekonominë e këtyre vendeve. Pasojat e rënda që shkakton krimi i organizuar, në fushën ekonomike dhe sundimin e së drejtës në përgjithësi, kanë bërë që luftimi serioz i krimit të organizuar të jetë një ndër kushtet e rëndësishme të anëtarësimit në Unionin Evropian. Por edhe përkundër kësaj, analizat e të dhënave statistikore tregojnë se krimi i organizuar në vendet e Ballkanit vazhdimisht është në rritje e sipërme, sidomos në R. e Shqipërisë, ku ka marrë përmasa shqetësuese.⁴

Krimi i organizuar sot më së shumti vepron dhe është i pranishëm aty ku ka më shumë profit, sidomos krimi ekonomik, tregtia me substanca narkotike, tregtia me qenje njerëzore, kontrabanda, falsifikimet, pirateritë etj. Prandaj krimi i organizuar edhe më tej do të mbetet një shqetësim përparësor i shoqërive europiane në të ardhmen. Sipas ekspertëve të CoE, Europa është tani ndoshta tregu më me përfitim në botë përse i përket prodhimit dhe trafikimit të drogës. Përveç Shqipërisë, me krimin e organizuar përballen edhe shtetet tjera, sidomos Rumania, Ukraina, Bullgaria dhe Lituania, që janë vendet më të shumta të origjinës së rasteve në trafikimin e qenieve njerëzore. Më poshtë do të përshkruajmë formën, mënyrën, strukturën dhe veprimin e disa organizatave kriminale, siç janë: Cosa Nostra, Ndrangeta, Comora, Jakuzja Japoneze, Triada Kineze etj.

1.2. Cosa Nostra

“Cosa Nostra” si organizatë kriminale ndërlidhet me pjesëtarët e komunitetit italian dhe u paraqit në Itali, më saktë në Sicili. Prandaj në fillim, gjatë studimit të këtyre grupeve kriminale, shumica e hetuesve

⁴ Në vitin 2017 është ngritur akuzë kundër Ministrit të punëve të brendshme, Saimir Tahirit, për trafik të lëndëve narkotike të kryer në bashkëpunim dhe korrupsion i zyrtarëve të lartë. Ky është zyrtari i parë i nivelit kaq të lartë në Shqipëri që akuzohet për krim të organizuar. Në Shqipëri ka filluar të zhvillohet procesi i Vettingut, që ka për qëllim filtrimin e sistemit të drejtësisë, ku një numër i konsiderueshëm i gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk e kanë kaluar këtë proces.

dhe shkencëtarëve e kufizonin punën e tyre vetëm brenda komunitetit italian, duke pohuar se jashtë këtij komuniteti nuk ka krim të organizuar. Kjo erdhi për shkak të mënyrës së funksionimit të këtyre organizatave, e që trangu ishte familja, prandaj në fillim ato përbëheshin vetëm nga italianët, për shkak të mosbesimit ndaj komuniteteve tjera. Pjesëtarët e komunitetit italian, sidomos nga krahina e Sicilisë, filluan të shkonin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në pjesën e fundit të shekullit XIX, rreth vitit 1880, ose pak më vonë. Fillimisht u vendosën në New Orleans dhe më pas u shtrinë në kryeqendrat e SHBA-së. Emigrimi i tyre u bë për dy arsye: e para, shkaqet ekonomike i detyruan të migronin në SHBA, dhe e dyta emigrimi në SHBA i një numri të madh italianësh që ishin marrë me krime, dhe për shkak se shumë mafiozë nga Sicilia, për t'i shpëtuar ligjit në Itali, u detyruan të shkonin në SHBA. Janë 5 familje në Amerikë që mbanin kontakte të ngushta me krerët në Itali: Familja Bonano, Lukese, Kolombo, Xhenovese dhe Gambino, ku dy të fundit marrin pjesën më të madhe të fitimeve. Çdo njëra nga 5 familjet e Nju Jorkut ndërtoi perandorinë e vet, duke u marrë me aktivitete të jashtëligjshme si shantazh, pastrim parash, vrasje, lëndë narkotike, kumar, grabitje, menaxhimin e mbeturinave etj. Sipas disa mafiozëve, emri i vërtetë i mafias është “Cosa Nostra” që d.m.th., Çështja Jonë. Kjo organizatë mbështetej tek familja si bërthama më e sigurt, që përbëhej prej “burrave të nderit”. Ata burra që i përkisnin organizatës, nuk kishin nevojë të prezentoreshin me njëri-tjetrin, ata njiheshin si pjesëtarë të Cosa Nostra ose “La stessa cosa” (E njëjta çështje), që do të thotë mafioz si ti dhe përbënin trangun e njëjtë. Cosa Nostra është përdorur në Shtetet e Bashkuara nga Joseph Valachi, një mafioz i kthyer në dëshmitar shteti gjatë shqyrtimit të Komisionit McClellan. Në atë kohë, përcaktimi i emrit mori famë të gjerë dhe pothuajse e zëvendësoi termin mafia. FBI-ja madje shkroi një artikull të posaçëm për këtë çështje, duke e quajtur “La cosa nostra”.

1.2.1 Organizimi

Celula kryesore është e përbërë nga “familja”, një strukturë me bazë territoriale që kontrollon një pjesë apo një zonë të qytetit. Familja është e përbërë nga “burrat e nderit” ose “ushtarët” të koordinuar dhe udhëhequr nga një shef i zgjedhur i quajtur edhe “përfaqësuesi”, i cili pasohet nga një “zv/shef” dhe nga një ose më shumë “këshilltarë”. Nëse ngjarje të rastit bëjnë të pamundur zgjedhjen normale të shefit nga anëtarët e familjes, “komisioni” organizon emërimin e “anëtarëve të

këshillit” që të administrojnë përkohësisht familjen deri në kohën e zgjedhjeve normale. Aktiviteti i familjeve koordinohet nga një organizëm kolegjal i quajtur “kupola”, ku bëjnë pjesë përfaqësuesit e tre apo më shumë familjeve të afërta. Komisioni drejtohet nga njëri prej përfaqësuesve të familjeve. Komisioni ka një rreze veprimi të gjerë, si dhe ka detyrën për të siguruar respektimin e rregullave të “Cosa Nostra”-s brenda secilës familjeje, e mbi të gjitha, të zgjidhë konfliktet ndërmjet familjeve. Shefat historikë të “Cosa Nostra”-s siçiliane kanë qenë Vito Kashio Ferro, Kaloxhero Vicini, Mikele Navarra, Luciano Lixhio, Mikele Greko, Gaetano Badalamenti, Stefano Bontade, Salvatore Riina, Bendeto Santapaola, Bernardo Provenzano.

1.2.2 Al Kapone

Në qoftë se ka ekzistuar ndonjëherë ndonjë mafioz aq i fuqishëm e brilant sa të meritonte të ishte në krye të kësaj liste, ai është Al Kapone. Emri tij i vërtetë është Alphons Capone, dhe lindi në Brooklyn në vitin 1899. Ishte fëmija i katërt, nga nëntë fëmijët e familjes Kapone. Prindërit e tij ishin emigrantë nga Italia. Në moshën 12 vjeçare e larguan nga shkolla fillore, për shkak se mësuesen e klasës e goditi me shuplakë. Pas kësaj, me kënaqësi iu bashkua bandave në rrugët e Bruklinit. Ai që në moshë të re dallohej nga fëmijët tjerë, për shkak të agresivitetit dhe prirjes për të prishë rendin dhe qetësinë. Gjatë rrahjeve, ai në një rast mori edhe disa çarje të fytyrës, të cilat do t’i mbante gjatë tërë jetës dhe do të emërtohet si njeriu me shenjë ose scarface. Al Kapone thoshte se atë shenjë e kishte marrë gjatë një lufte ku kinse kishte marrë pjesë, por që nuk ishte e vërtetë. Për shkak të agresivitetit dhe veçorive tjera, ai i ra në sy një gangsterit që tanimë kishte ngritur grupin e vet në Nju Jork, me emrin Frenki Jal. Këtu Al Kapone së shpejti bëhet udhëheqës i biznesit me prostitucionin dhe pronar i 2 bareve të natës. Por, për shkak të karakterit të tij, së shpejti bie në një sherr me dy persona dhe të dy i godet për vrasje. Pas kësaj, në vitin 1919 Al Kapone largohet në Çikago, ku e pranon një mik i Frenki Jalit me emrin Xhoni Torrio, që po ashtu ishte një gangster i cili kishte bizneset e veta me kazino dhe prostitucion. Këtu Kapone u bë mbrojtësi i Torrios. Ishin kohëra trazirash e depresionesh, kështu që pa asnjë problem Kapone zhvilloi prostitucionin, bastet dhe kontrabandën e alkoolit. Pozita e tij u fuqizua në kohën e prohibicionit amerikan, me të cilën u ndalua shitja e alkoolit. Jony Torrio dhe Kapone kontrabandonin alkoolin, sidomos ditëve të uiken-dit, kur shiteshin sasi të mëdha të alkoolit. Në këtë periudhë, në Çikago

kishte edhe grupe tjera të krimit të organizuar, që herë herë kishte edhe fërkime mes tyre. Prandaj Al Kapone mori një iniciativë që të arrihej një marrëveshje mes grupeve duke ndarë territorin e qytetit në mes bandave, me ç'rast kuptohet se vendi më i madh dhe më atraktiv i takoi Al Kapones. Në vitin 1925, Torrio u plagos në një përleshje midis familjeve mafioze dhe pas kësaj u tërhoq nga krimi i organizuar. Pas kësaj, Kapone vetëm 25 vjeç, u bë kryetar i familjes. I njohur për inteligjencën e tij të jashtëzakonshme, për dëshirën për të qenë i famshëm, ai njihej gjithashtu edhe si një person jashtëzakonisht i rrezikshëm dhe ekstremisht i dhunshëm. Por, ai njihej edhe si Robin Hodi i vendit, sepse shuma të konsiderushme të parave jepte për qëllime humanitare-bamirëse. Ai mbetet i njohur për shkak të orkestrimit të masakrës së Shën Valentinit në vitin 1929, ku disa pjesëtarë të grupit ishin veshur me uniforma të policisë dhe kishin shkuar tek magazina e organizatës tjetër, e të cilët duke menduar se ishin policë, sipas urdhërit ishin kthyer kah muri. Kjo masakër do të njihet si masakra e Shën Valentinit, që shkaktoi revoltë të madhe tek qytetarët. Edhe pse Al Kapone paraprakishtë kishte shkuar në një qytet tjetër, të gjithë e dinin kush e kishte organizuar këtë vrasje. Në vitin 1939, agjenti federal i thesarit Eliot Ness, e arrestoi atë për evazion fiskal.

1.3 Camora

Derisa mafia italo-amerikane është dobësuar dekadat e fundit nga forcimi i ligjit, mafia italiane në vendin e origjinës vazhdon të mbetet e fortë. Pavarësisht përpjekjeve prej disa vitesh të qytetarëve, gazetarëve dhe zyrtarëve të qeverisë, përsëri qeveritë lokale në Itali mbeten të lidhura me grupet mafioze. Camorra fiton 7.2 miliardë euro në vit nga trafiku i drogës, 2.5 miliardë nga riciklimi i parave të pista në aktivitete kriminale dhe nga ndërmarrjet e lidhura me krimin, 258 milionë euro nga prostitucioni, 2.1 miliardë nga trafiku i armëve, 362 milionë nga ushtrimi i dhunës dhe shantazheve. Një xhiro që në total shkon deri në 12 miliardë euro për familjet napolitane. Camora bazën e ka në Napoli. Grupi ka nisur aktivitetin që në shekullin e 19-të, kur u formua fillimisht nga një bandë në burg. Kjo organizatë është themeluar nga mesi shekullit XVI në Napoli. Fjala “Camorra” dikur kishte kuptimin e një takse që paguhej nga pronarët e lokaleve për të siguruar mbrojtje. Këto të dhëna i përkasin Mbretërisë së Napolit dhe datojnë më 1735. “La Camorra” aktualisht vepron në 111 vende (përfshirë këtu qytete dhe provinca). Struktura e saj është e ngjashme me atë të “Cosa Nostra”-s,

ku çdo familje zotëron një zonë të caktuar. Camorra (Mafia Napoletane) përbehej prej 200 familjeve me rreth 6700 anëtarë. Sot kjo organizatë thellë ka depërtuar në Shqipëri me bizneset e drogës dhe prostitucionit. Sipas mediave italiane, gjurmë të saj janë të pranishme edhe në Holandë, Spanjë, Portugali, Rumani, Francë, Republika Dominikane, Brazil, Gjermani, Poloni, Rusi, e disa shtojnë dhe Shqipërinë. Camorra ka ndikim edhe mbi klubin italian Napoli dhe kanë qenë të dukshme lidhjet e organizatës me futbollistin e famshëm Diego Maradona.

1.4 Ndrangheta

Cosa Nostra mund të jetë grupi kriminal më i famshëm në botë, por ata nuk janë më të fuqishmit. Falë arrestimit të bosëve të mëdhenj, dikur të paprekshëm, Cosa Nostra, ka pësuar rënie viteve të fundit në sajë të një lufte të pamëshirshme të zhvilluar nga prokurorët dhe policia federale e SHBA-së dhe Italisë. Tashmë bota e nëndheshme e krimit ka një padron të ri: 'Ndrangheta. Ndrangheta është themeluar që në vitin 1860 nga një grup sicilianësh të përzënë nga ishulli i tyre i vendlindjes. Një luftë në mes organizatave të krimit në vitin 1980 mbaroi me 700 të vdekur, ku shumica ishin pjesëtarë të Ndrangetës. Kjo organizatë, që ngjan më shumë me një shoqëri sekrete, sot importon rreth 80% të kokainës në Europë nga Meksika dhe Kolumbia. Ndrangheta është si një oktapod dhe kudo që ka para, do të gjeni këmbët e saj. Krimi më i njohur i Ndrangetës ishte rrëmbimi në Romë i 16-vjeçarit, John Paul Getty, nipi i njeriut më të pasur në botë, në vitin 1973. Tregtari i naftës Getty, në fillim nuk pranoi të paguajë shumën që kërkohej prej 2.7 milionë dollarë. Por kur organizata preu njërin vesh të fëmijës, atëherë u kuptua serioziteti dhe u bë pagesa. Një nga rrëmbyesit e fëmijës ishte kriminel i njohur Saverio Mammoliti, me nofkën Playboy. Ai për shkak të veprave penale ka qenë i dënuar me burg afatgjatë, por në vitin 1972 u arratis nga burgu. Në këtë periudhë, edhe pse i dënuar, Mammoliti jetonte haptazi, pa frikën e arrestimit për të vuajtur dënimin prej 20 vite burg. Madje u martua me të dashurën e tij në një kishë që gjendej shumë afër një stacioni policie. Në vitin 1975 Mammoliti u arrestua për transportin e heroinës dhe kokainës. Pas një gjyqi masiv kundër Ndrangetës në 1982, ai u dënua me 33 vjet burg, por, për shkak të korrupsionit, ekzekutimi i dënimit u ndalua nga gjykata e apelit. Dy vjet më vonë ai përsëri u akuzua për vrasje dhe tani nga presioni i madh iu konfiskua prona që shkonte me miliona dollarë. Por çuditërisht akuza u tërhoq dhe si rezultat i kësaj pasurie e konfiskuar iu kthye përsëri. Në vitin 1992

Mammoliti dhe gruaja e tij Maria u arrestuan për korrupsion, por edhe kësaj rradhe u liruan për “mungesë” provash. Pas disa muajsh forcat policore antimafia kishin siguruar prova të bollshme për veprat penale të vrasjes, gjashtë bombardime dhe 19 grabitje, për të cilat ai u shpall i fajshëm dhe u dënua me burg të përjetshëm. Pas një dekade qëndrimi në burg, në vitin 2003 Mammoliti pranoi të bashkëpunonte me skuadrën antimafia, duke zbuluar tërë strukturën e organizatës Ndrangeta, bizneset e paligjshme dhe kush ishin zyrtarët e korruptuar. Ai gjithashtu pranoi se kishte qenë një nga rrëmbyesit e fëmijës në vitin 1973 dhe se personalisht ia kishte prerë veshin fëmijës. Bashkëpunimi me Mammolitin sollën edhe zbulimin e fortesave nëntokësore të Ndranghetës në Kalabri. Kur Mammoliti u kthye në bashkëpunëtor të policisë, Ndrangheta bëri reforma brenda organizatës, ashtu që bosët krijuan “La Santa”, një shoqëri e fshehtë brenda një shoqërie sekrete. Për t’iu shmangur përgjimit, ata merreshin vesh me fishkëllimat që përdornin barinjte në Kalabri. Në vitin 1991, tre anëtarë të organizatës vranë një kasap në rajonin Taurianova në mes të ditës, për të cilin dyshonin se ishte bashkëpunëtor i policisë. Ia prenë kokën me një nga thikat e tij dhe e përdorën kokën e prerë për praktikë në mes të sheshit kryesor të fshatit.

Policia antimafia, gjatë viteve 2001-2008 kishte pasur rezultate të mira në konvertimin e anëtarëve të mafies në bashkëpunëtorë të policisë, kështu ishin mbi 1.000 të penduar (informatorë) nga Cosa Nostra siciliane, 2.000 nga Camorra e Napolit, por vetëm 42 nga Ndrangheta kalabreze. Kjo tregon se edukimi dhe trajnimi i anëtarëve të Ndranghetës është shumë më i fuqishëm dhe bindës krahasuar me organizatat tjera. Nga kjo shihet se autoritetet e skuadrës antimafia nuk kanë patur shumë fat për të konvertuar pjesëtarët e Ndranghetas që të spiunonin njëri-tjetrin, për shkak se shumica e tyre ishin në lidhje gjaku dhe përbënin familjen në kuptimin e plotë të fjalës. Ndryshe nga kjo, Cosa Nostra pranonte edhe të huaj si “familje”, që ka ndikuar një numër i madh të konvertoheshin dhe të bashkëpunonin me policinë. “Ndrangheta” është shumë e pasur; kjo organizatë në vitin 2013 ka pasur 60 miliardë dollarë të ardhura, shumë kjo më e madhe se sa të ardhurat e McDonald dhe Deutsche Bank së bashku. Bizneset e Ndranghetës sot shtrihen nga Kalabria, në Kolumbi dhe deri në Australi. Ngritja e “Ndrangheta-s” u ndihmua edhe nga gabimet strategjike të mafias siciliane. Në fund të viteve 1980, “Cosa Nostra” nisi një politikë “antishtet”, që kulmoi me vrasjen e dy gjykatësve kryesorë të antimafias, Giovanni Falcone dhe Paolo Borsellino, në vitin 1992. Kjo solli që

qeveria të reagojë në mënyrë të ashpër kundër Cosa Nostras, duke dërguar forca të mëdha të policisë dhe ushtrisë në Sicili. Një situatë e këtillë dëmtoi jashtëzakonisht shumë interesat e “Cosa Nostra-s”. Ndërkohë që autoritetet italiane dhe media ishin fokusuar tek Cosa Nostra dhe sicilianët, kjo i dha hapësirë Ndrangetës që të zhvillohej shpejtë dhe të vendoste nën kontroll territoret që dikur i përkisnin Cosa Nostras. Në vitin 1994, katër liderët e mafies kryesore në Itali u takuan në Liqenin e Komos për të ndarë tregun në veri të vendit. “Ndrangheta” mori 70 për qind të saj, si rezultat i fuqisë dhe ndikimit që kishte arritur në dy dekadat.

1.4.1 Organizimi, struktura dhe hierarkia e Ndranghetës

Ndrangeta ka një organizim karakteristik pasi ndahet në nivele.

Niveli më i ulët është **Giovane d'onore** (I ri nderi). Ky titull ka të bëjë me “të drejtën e gjakut”, që merret në momentin e lindjes dhe ju takon vetëm fëmijëve të ndrangetistëve.

Niveli dytë është **Uomo d'onore** (Burrë nderi), që merret në moshë të caktuar dhe pasi të ketë treguar bujarinë ndaj organizatës.

Picciotto d'onore (Ushtar nderi). Është grada e parë e vërtetë e ‘karrierës’ ndrangetiste. Bëhet fjalë për pjesëtarët e organizatës që janë të detyruar të zbatojnë urdhërat e nivelit më të lartë, pa të drejtë për të vlerësuar ato. Pra, tani ata paraqiten thjeshtë vetëm si një instrument që duhet ekzekutojë urdhrat, duke iu bindur plotësisht atyre. Ushtarët, në praktikë, janë këmbët ose më mirë thënë trupi i kapove të bandave kalabreze.

Sgarritsta (Bosat e vegjël) janë persona që përdoren për mbledhjen e ryshfeteve.

Santista (I shenjtë). Ai që merr këtë gradë do të thotë se ka përparuar shumë në fushën e krimit, pra e merr atë për merita kriminale.

Quintino (i Pesti) është grada më e lartë që një ndrangetist mund të arrijë. Kjo i atribuohet një numri të kufizuar mafiozësh që njihen për përgjegjësitë e tyre të mëdha në organizatë dhe që mbajnë një tatuazh një yll me 5 cepa.

Associazione (Shoqata). Përfaqëson pushtetin më të lartë të Ndrangheta-s dhe paraqet trup kolektiv. Në këtë nivel arrijnë kapot e familjeve që përfshihen në një numër të madh degësh, kanë aleancë dhe mbrojtje politike, dhe që janë të aftë të ndikojnë jo vetëm në krahinën dhe zonën e tyre, por edhe në organizatat jashtë vendit.

“**Sorella d’omerta**”. Një rregull tjetër në funksionimin e Ndranghetës, është ajo e gruas në mafian kalabreze “sorella d’omerta”. Gruaja ka një rol të rëndësishëm dhe në funksionimin e Ndranghetës është mjaft e përkushtuar. Asaj i besohen detyra të rëndësishme dhe ka për detyrë të ndihmojë të arratisurit. Mirëpo, femra është e kufizuar në karrierën e saj, ajo më së shumti mund të arrijë deri tek grada Santista (I shenjt). Por, roli i gruas në mafien kalabreze nuk përfundon këtu. Qysh në krijimin e organizatës, gratë bënin pjesë në të. Gjykatësit shkruajnë: “Të veshur si burra, ato merrnin pjesë në vjedhje dhe në vepra të tjera penale”. Sot, gratë merren me mbledhjen e ryshfeteve, janë pronare të barave të natës, mbajnë lidhje me të arratisurit dhe pjesën e jashtme të burgut.

Ndrangheta nuk funksionon si Cosa Nostra; kjo organizatë është si një federatë familjesh mafioze që janë bashkuar për t’u koordinuar mes tyre, por që përgjithësisht janë të pavarura. Me Cosa Nostran, nëse i pret kokën, trupi vdes. Por Ndrangheta është më shumë si Hidra në mitologjinë greke, gjarpri me shumë koka, të cilit i rriteshin dy koka, për çdo një që i prisje, lindte tjetra. Kur Carmelo Novella, kreu i Ndrangheta-s në Lombardi, u përpoq të vepronte në mënyrë të pavarur, ai u vra në vitin 2008 nga një prej drejtuesve të mafies në Kalabri. Përveç betimit mbi Bibël, anëtarët e rinj betoheshin përpara një arme dhe një pilule vetëvrasjeje, për të cilën betoheshin se do e përdornin nëse do të kapeshin ndonjëherë nga policia. Kjo organizatë ka tashmë mbi 10 mijë anëtarë në botë.

1.5 Triada kineze

Fjala Triada e ka kuptimin e trekëndëshit kryesor Qiellit-Tokës-Njeriut. Këto janë tri shtyllat kryesore të kozmosit sipas mitologjisë kineze. Fillet e kësaj organizate mund të themi që janë më të lashtat në krahasim me të gjitha organizatat tjera mafioze dhe datojnë që në vitin 1760. Edhe pse është krijuar shekuj më parë, veprimtaria e saj kriminale ka nisur në vitin 1911, kur është kryer edhe vrasja e parë nga anëtarët e saj. Kjo organizatë veprimtarinë e saj e zhvillon në Hong-Kong, ku si aktivitete të saj janë tregtia me drogë, vjedhja, bixhozi, prostitucioni, rekitizmi, vrasjet me pagesë, tregtia me armë, shantazhet, trafikimi i emigrantëve për në Evropë, ShBA dhe shtete të tjera.

Gjithashtu, edhe Triada ka sindikatat e saja, ku më të njohurat janë: Sun Yee On, Wo Sing Wo, 14k, ku secila organizatë ka anëtarët e vet, ndërsa karakteristikë e tyre, sidomos e 14k, është simbol i Dragoit.

Triada sipas mënyrës së funksionimit dhe organizimit dallon nga mafia që ndërlihet me familjen dhe hierarkinë e fuqishme. Tek Triada, anëtarët e organizatës janë më të lirë në marrjen e vendimeve. Triada kineze përpos që vepron në Hong-Kong, ajo ka shtrirje edhe në Londër, New York, Manchester, kurse numri i anëtarëve kalon mbi 100 mijë.⁵

1.6 Jakuza Japoneze

Fjala Jakuza është e sajuar nga emrat e tre numrave, edhe atë, të numrit 8-ja, 9-ku, 3-za. Këta janë numrat e lojës së bixhozit, kurse vet emri Jakuza do të thotë lojtar - bixhozgj. Në Japoni njihet edhe si 893, kurse numri i anëtarëve të kësaj organizate kalon mbi 50 mijë. Jakuza i ka origjinat e saj në federatën e kumarxhinjëve dhe tregtarëve të rrugës së Periudhës Edo (prej shekullit XVII deri në atë XIX), e cila me kalimin e kohës evoluoi në organizatë kriminale siç është edhe sot. Jakuza si organizatë kriminale merret me një sërë veprimesh kriminele, siç janë: prostitucioni, larja e parave, tregtia me narkotikë, tregtia me armë, shantazhe, reketizëm etj. Kjo organizatë, përpos që vepron në Japoni, vepron edhe në shtete të tjera, siç janë: Filipinë, Honkong, Korea Jugore, Havaje, në SHBA, Amerikën Latine, si dhe në Evropë. Jakuza është ndër mafiat më të vjetra dhe më të përgjakshme në botë. Jakuza japoneze vepron si një familje e madhe, ku anëtarët e saj, për të treguar aleancë të përjetshme vëllazërore, bëjnë pirjen e gjakut të njëri-tjetrit. Gjithashtu, karakteristikë e tyre janë mbajtja e flokëve të shkurtëra, tatuazhet e ndryshme në trup dhe shpesh mungesa e gishtit të vogël, që pritet në rastet kur anëtari ka bërë dhe pranon ndonjë gabim të vogël, por edhe në shenjë të besimit ndaj organizatës. Tatuazhet tregojnë se çfarë rangimi personi ka në organizatë. Jakuza po ashtu ka sindikatat e fuqishme të cilat quhen Sumiyoshi-Rengo dhe Inagawa-Kai në Tokio. Veprimtaria e Jakuzës kryekëput ka të bëjë me veprimtari të paligjshme, të cilat i sjellin përfitime të mëdha, andaj ata bëjnë çmos për të siguruar ndalimin e policisë dhe organeve gjyqësore.

Conclusion

Organized crime is one of the major challenges faced all countries of the world, without exception. But after the terrorist acts of 2001, the world left behind the fight against organized crime, focusing on

⁵ Gjatë vitit 2015, policia Kineze arrestoi mbi 19 mijë anëtarë të Triadës.

combating terrorism. Even today, criminal state policies continue, giving priority to the fight against terrorism, which on the other hand has given space and advantage to developing criminal organizations. In the next article, we will pay attention to other organized crime organizations in Europe, especially the organization and functioning of Albanian mafia organizations, operating in the Balkans and Europe.

Recensentë:

Prof dr. Vlado Kambovski

Prof dr. Bajram Pollozhani

BIBLIOGRAFIA

- Abadinsky, H., (1994), Organized Crime, Chicago.
- Adams, T.F., (2004), Crime scene investigation, Prentice Hall, Upper Saddle River.
- Organized crime and 21 Centuri Seminar, (1999), The university of Hong Kong
- Pavišić, B., (2006), Kriminalistika, Zagreb.
- Pavišić, B., (2006), Kriminalistika I. Rijeka.
- Јоханес, В.-Михаел, Х., (2009), Казнено Право (посебен дел), Shkup.
- Kažić, D., (1996), Fotografija, Beograd.
- Камбовски, В., (2005), Организиран Криминал, Shkup.
- Korajlić, N., (2012), Istraživanje Krivičnih Dela, Sarajevë.
- Kolar, T., (1999), Praktikum Kriminalističke tehnike, Zagreb.
- Kolonowski, E., (1996), Upustva za Eskhumacija, Sarajevë, Reykjavik-Miami.
- Kirk, P., (1953), Crime investigation, New York.